


SAKRAMENTET E KISHËS KATOLIKE

Kemi folur në lidhje me Sakramentet e Kishës Katolike, që ishin 7 shenja të shenjta. Kemi dhënë edhe burimet zyrtare që janë të njëjtat për çdo sakrament, pra Faqja zyrtare e Katekizmit të Kishës Katolike: vatican.va; websiti i fetërve domenikanë dhe Atit Angelo Bellon “Amici Domenicani”, si dhe websiti dhe faqja YouTube e priftit italian Don Leonardo Maria Pompeit: In Voluntate Dei. I kemi ndarë Sakramentet në 3 grupe të mëdha: Sakramentet e Hyrjes në jetën e krishterë (Pagëzimi, Krezmimi, Kungimi); Sakramentet e Shërimit (Rrëfimi dhe Vajimi) dhe Sakramentet në shërbim të bashkësisë e të misionit (Martesa dhe Urdhri i shenjtë). Do të flasim tani për Sakramentin tjetër që bën pjesë në Sakramentet e Shërimit, që është Sakramenti i Vajimit.

SAKRAMENTI I VAJIMIT

Vajimi është një nga shtatë Sakramentet e Kishës Katolike. Besoj se kur flasim për Sakramentet, edhe ndër besimtarët, ka disa që janë më të njohur dhe pothuaj më “interesantë”, për të cilët dimë më shumë, kurse disa të tjerë të cilët i lëmë pothuaj fare në hije. Mendoj se ky Sakrament është një nga ata që lihen në hije, fatkeqësisht. Por, si çdo gjë në jetën tonë, një gjë lihet në hije, lihet mbrapa, anashkalohet, kur nuk i dihet rëndësia, pra kur njihet pak ose aspak në lidhje me të. Atëherë, për t’i dhënë rëndësinë e duhur këtij Sakramenti duhet ta njohim, të dimë më shumë për të, çfarë është ai, çfarë realizon në shpirtin e njeriut dhe efektet e tij.



1. ÇFARË ËSHTË VAJIMI?

Vajimi i të sëmurëve (ose Vajimi) është një nga shtatë Sakramentet e Kishës Katolike, i cili ka “rolin” specifik për të ngushëlluar të sëmurët. Kisha e ka praktikuar gjithnjë këtë Sakrament, si në Lindje, ashtu edhe në Perëndim, Kjo praktikë ka të bëjë me lyerjen me vaj të bekuar të të sëmurit. Ndër shekuj, Vajimi i është administruar (dhënë) praktikisht atyre të sëmurëve që ishin në prag të vdekjes, prandaj për këtë arsye njihet edhe me emrin Vajimi Ekstrem. Më 30 nëntor të vitit 1972 në Kushtetutën apostolike “Sacram Unctionem infirmorum” është përcaktuar që:

“Sakramenti i Vajimi i jepet të sëmurëve në rrezik të madh, duke i lyer në ballë e në duar me vaj të bekuar siç duhet- vaj ulliri ose vaj tjetër vegjetal- duke thënë vetëm një herë: “Për këtë Vajim të shenjtë dhe për mëshirën e tij të shenjtë të ndihmoftë Zoti me hirin e Shpirtit të Shenjtë, duke të të liruar nga mëkatet, të shpëtoftë dhe për mirësinë e tij të lehtësoftë”.

2. KUR U THEMELUA SAKRAMENTI I VAJIMIT?

Sikurse Sakramentet e tjera të Kishës Katolike, edhe **Sakramenti i Vajimit është themeluar nga vetë Jezu Krishti**, pra është një sakrament me institucion jo njerëzor, por hyjnor. **Themelet biblike të këtij Sakramenti i gjejmë së pari në Letrën e Jakobit** (siç e dimë, Jakobi është një nga apostujt e përzgjedhur nga vetë Jezu Krishti):

“Është ndokush ndër ju i sëmurë? Le t’i thërrasë priftërinjtë e Kishës! Ata le të luten mbi të duke e lyer me vaj në emër të Zotit dhe lutja e fesë do ta shpëtojë të sëmurin dhe Zoti do ta ripërtërijë e, në qoftë se ka bërë mëkate, do t’i falen”. (Letra e Jakobit, 5, 14-15)

Këto janë vargjet biblike, që i gjejmë pra në Letrën e Jakobit, që është pjesë e Besëlidhjes së Re.

Po ashtu, flitet për Vajimin edhe në ungjillin sipas Markut, kapitulli 6, më specifikisht vargu 13. Le ta lexojmë tërësisht pjesën në të cilën flitet për këtë Sakrament:

*“Atëherë i thirri të Dymbëdhjetët e nisi t’i dërgojë dy nga dy dhe u dha pushtet mbi shpirtat e ndytë. U urdhëroi të mos marrin në udhëtim asgjë tjetër, përveç shkopit: as bukë, as strajcë, as para bakri në brez, por të mbathin vetëm sandalet e të mos veshin dy palë petka. Dhe u thoshte: “Kudo që të hyni në ndonjë shtëpi, rrini aty derisa të largoheni nga ai vend. Po qe se ndokund nuk ju pranojnë dhe nuk ju dëgjojnë, dilni dhe shkundni pluhurin nga këmbët tuaja si dëshmi kundër tyre.” Ata shkuan dhe u predikuan njerëzve kthimin kah Hyji. Dëbonin shumë djaj, **lyenin me vaj shumë të sëmurë dhe i shëronin**”.* (Marku 6, 7-13)

Sa bukur! Pra, vetë Jezusi i dërgon apostujt, të Dymbëdhjetët, e përzgjedhur nga ai (ndër të cilët patjetër ka qenë edhe vetë Jakobi, i cili siç e lexuam pak më sipër, është ai që ka folur më drejtpërdrejtë për Vajimin). Kështu që, ata çfarë bëjnë? Bëjnë atë që ju thotë Jezusi: shkojnë dy nga dy, se vetëm nuk i dërgon, dhe kjo është diçka shumë e bukur që na flet për delikatesën dhe përkujdesjen e Jezusit për apostujt e vet, nuk marrin asgjë me vete (përveçse një palë rroba dhe një palë sandale, jo të tjera, por ata që kishin veshur), pra simbol i vërtetë i thjeshtësisë dhe i varfërisë së apostujve, si edhe i braktisjes së tyre ndaj të ashtuquajturës Provani Hyjnore, pra largohen me sigurinë që edhe pse Jezusi nuk ishte me ta fizikisht, do i shoqëronte shpirtërisht dhe Hyji do të përkujdesej tërësisht për ta. Kështu që ata shkojnë, krejt të kënaqur, futen nëpër shtëpi të ndryshme, rrinë në këto shtëpi (dmth në ata që i pranojnë se jo të gjithë do t’i pranojnë), hanë edhe bukë (atë çka u jepet) me njerëzit e këtyre shtëpive (imagjinoni sa shumë besim kishin apostujt, që të shkonë të hanë edhe atë që ju jepet, dikush mund të mendojë: po sikur t’u japin gjëra të prishura; po sikur ajo gruaja e shtëpisë të mos dijë të gatujë, si do ja bënin këta të shkretët, se s’mund të refuzonin), për më tepër s’kishin marrë as çantë me vete kështu që s’kishin as lekë nqs donin të blinin ndonjë hamburger apo diçka të tillë – edhe pse në ato kohë fatkeqësisht (ose fatmirësisht, varet) nuk ekzistonin McDonalds apo fast food të tillë. Pra, në këtë aspekt ja çajmë hallin apostujve të shkretë!

Pastaj, përveçse për të ngrënë, për të pirë e fjetur në shtëpi të huaj, çfarë do të bënin apostujt, ose më mirë a do të bënin ndonjë gjë apo kishin shkuar për qejf, si të ishin për pushime? Po pra, na thotë gjithnjë Marku, të cilit duhet t’ja ketë treguar këto aventura vetë Shën Pjetri, pasi Shën Marku ishte nxënës i Shën Pjetrit dhe Pjetri dihet që ishte një ndër apostujt, përbiles kreu i apostujve, që ata i predikonin njerëzve, pra bënin predikimin e Fjalës së Hyjit, pak a shumë atë që bën sot prifti psh. gjatë homelisë në Meshë; dëbonin djaj, që është ajo që bëjnë specifikisht priftërinjtë ekzorcistë, por në mënyrë më të gjerë edhe çdo besimtar kur lutet për veten e për të tjerët... dhe pastaj çfarë bënin tjetër? Kishin marrë me vete ca vaj, ose ndoshta jo se Jezusi u kishte thënë mos merrni asgjë, kështu që duhet të kenë bekuar vajin që gjenin në shtëpitë e njerëzve, dhe me këtë vaj lyenin të sëmuret e

kështu i shëronin, pra këtu gjejmë fillimet e atij që ne e quajmë Sakramenti i Vajimit, pasi ajo çka bënin apostujt në kohën e Jezusit, siç e lexuam, dhe ajo çka bëjnë pasardhësit e apostujve sot, që janë Ipeshkvit, por e shtrirë kjo gjë edhe tek priftërinjtë e tjerë të Kishës Katolike, është e njëjta gjë: pra të lyejnë të sëmurët me vaj për të lehtësuar sëmundjen e tyre, për t'i shoqëruar në këtë sëmundje me hirin e Zotit dhe nqs Zoti do, për t'ju dhënë atyre shërimin nga kjo sëmundje.

3. KUJT MUND T'I JEPET VAJIMI?

Thamë më sipër që Vajimi njihet edhe me emrin Vajimi Ekstrem, pasi ndër shekujt i jepej praktikisht të sëmurëve në prag të vdekjes. Sidoqoftë, edhe pse kjo është praktika e zakonshme, duhet të themi që Sakramenti i Vajimit nuk është një sakrament që u jepet vetëm të sëmurëve që janë duke vdekur. Atëhere kur duhet të jepet? **Koha më e mirë për ta marrë këtë Sakrament është kur një besimtar, për shkak të një sëmundjeje ose të plakjes, fillon të jetë në rrezik vdekjeje.** Fillon të jetë, pra jo modeomos duhet të jetë në momentin e fundit të jetës së tij, pak para se të mbyllë sytë përgjithmonë në këtë jetë. Tani, e thamë që ky Sakrament është themeluar kryesisht për të ndihmuar dhe lehtësuar besimtarët e sëmurë. Ky ngushëllim mund dhe duhet të jepet në çdo rast që besimtari mund të rrezikojë jetën e tij.

Për këtë arsye, është e përshtatshme, që përpara një operacioni të vështirë kirurgjik (s'po them tani një operacion i heqjes së bajameve me gjithë respektin, edhe pse e ka edhe ai rrezikun e vet), por psh. një operacion me rrezik të madh, siç janë operacione të vështira në zemër, të heqjes së tumoreve të vështira, operacione mbi gratë shtatzënë në rrezik për jetën apo të humbjes së fëmijës e gjëra të tilla ku mund të vihet në rrezik me taman jeta e njeriut, është shumë e këshillueshme që besimtari të marrë Sakramentin e Vajimit, që të futet në operacion me këtë ngushëllim dhe ndihmë të madhe nga Hyji.

Po ashtu, nqs një besimtar ka një sëmundje që e vë disa herë në rrezik për jetën, **Vajimi mund të jepet disa herë, pra mund të përsëritet**, për aq herë që besimtari e ndjen të nevojshme marrjen e këtij Sakramenti pasi i vihet në rrezik jeta. Psh, një shok, i cili është i sëmurë me një tumor në gjak, e ka imunitetin shumë të dobët dhe shpeshherë, fatkeqësisht, merr infeksione në rrugët e frymëmarrjes që i shkojnë deri në mushkëri, të cilat për një imunokompetent do të kalonin banalisht, kurse atij, për shkak të imunitetit të dobët, mund t'i vihet shpesh në rrezik edhe vetë jeta e tij. Kështu pra, ky shok, po të dojë, përpara çdo shtrimi në spitali apo fillimit të një terapie, duke qenë se janë të rrezikshme për të, mund të kërkojë që të marrë Sakramentin e Vajimit.

4. KUSH MUND TA ADMINISTROJË SAKRAMENTIN E VAJIMIT?

Këtë pyetje në fakt ja kam bërë para ca kohësh vetes me shumë kureshtje dhe interes sepse kishte shumë pacientë të cilët, pasi u flisje për rëndësinë e Vajimit dhe të marrjes së këtij sakramenti, donin ta merrnin, me shumë dëshirë. Por, fatkeqësisht nuk arrinin dot ta merrnin sepse nuk gjendej një prift në kohë. Atëhere më lindi dëshira për të ditur se kush mund t'jua jepte këtë sakrament të sëmurëve, ose më mirë, a mund t'jua jepte vetëm prifti apo edhe... mjeku psh? Dmth unë, në atë rast. Pra, jo sepse doja të dilja sipër autoritetit të Kishës, larg qoftë, por sepse doja t'i ndihmoja sa më lehtë të sëmurët. Aq më tepër që ka të sëmurë nëpër shtëpi, për të cilët nuk është e lehtë të gjesh dhe të organizosh që një prift të vijë në shtëpinë e

tij, sidomos kur prifti s'ja ka parë kurrë fytyrën se kanë vite pa futur këmbë në kishë, ndoshta që prej... krezmimit ose martesës!

Pra, për të gjithë ata që duan ta dinë, si puna ime, **këtë Sakrament mund t'ua japin të sëmurëve vetëm Ipeshkvi dhe priftërinjtë**, nuk mund t'ua japin në asnjë mënyrë besimtarët e thjeshtë, laikët ose diakonët.

Pra, nqs jeni i sëmurë ose keni ndonjë njeri të sëmurë që ka nevojë për këtë Sakrament, për ngushëllimin që vjen nga ai gjatë sëmundjes, atëhere mos ngurroni të thërrisni priftin e famullisë suaj, e kishës lokale më të afërt, që të vijë e t'ja japë këtë Sakrament të sëmurit. Është detyrë e priftit të vijë në çdo moment që t'ja japë, sepse thamë që ky Sakrament është quajtur ndryshe edhe Vajimi Ekstrem dhe jepet sidomos në momente shumë të vështira për të sëmurin, kur vihet në rrezik jeta e tij nga sëmundja ose nga dobësia e pleqërisë.

5. CILAT JANË EFEKTET E SAKRAMENTIT TË VAJIMIT?

Jezusi dhe Kisha e tij na ofrojnë mbështetje të shumta nëpërmjet atyre rrugëve të ashtuquajtura të zakonshme për të përballuar jetën e përditshme dhe vështirësitë e problemet që jeta na paraqet ditë pas ditë, që janë Sakramentet. Kemi thënë që futemi në jetën e krishterë nëpërmjet Pagëzimit, e përforcojmë hirin, dhuratën e Shpirtit të Shenjtë, e marrë nga Pagëzimi nëpërmjet Sakramentit të Krezmimit, që ashtu sikurse Pagëzimi jepej vetëm një herë në jetë, dhe pastaj e ushqejmë këtë hir vazhdimisht nëpërmjet Sakramentit tejet të rëndësishëm të Eukaristisë dhe nqs për shkak të mëkatit të rëndë e humbasim, mund ta rimarrim nëpërmjet Rrëfimit. Pra, ka shumë “rrugë”, “mjete”, që Jezusi na ka dhënë për të ecur përpara me hirin e tij. Pse atëhere ishte e nevojshme që të “shpikëj”, të “krijohej” një Sakrament tjetër, përveç atyre që përmendëm? A nuk mjaftojnë ato që kemi, mua më duken të mjaftueshëm!



Po, e the mirë, mua, ty, pra ne që nuk jemi të sëmurë, por duhet të kemi parasysh (dhe këtë e them edhe duke qenë në kontakt me këtë botë pasi profesioni im është mjekë) që i sëmurit është si një botë më vete: sëmundja është një realitet shumë i thellë, shumë i vështirë, sidomos kur bëhet fjalë për sëmundje kronike, sëmundje që duket sikur nuk kanë një rrugëdalje, nuk kanë shërim, ose akoma edhe më shumë, kur bëhet fjalë për sëmundje që të japin vuajtje të vazhdueshme, si fizike, ashtu edhe morale e shpirtërore. Mjafton të përmendim psh. ata

të sëmurë që kanë stomi, pra që në një mënyrë të përkohshme ose të përhershme duhet të lëvizin me një si punë xhepi të jashtëm në të cilën mblidhen jashtëqitjet e të sëmurit, pasi mund t'i kenë bërë një operacion ku i kanë hequr një pjesë të zorrës së trashë. Ose ata të sëmurë me HIV, që përveç problemeve fizike që u jep sëmundja e tyre, që tani fatmirësisht është bërë gjithnjë e më shumë një sëmundje kronike dhe jo aq vdekjeprurëse si përpara, duhet të durojnë, sidomos në disa vende ku ekziston akoma paragjykimi i thellë kundrejt këtyre të sëmurëve, paragjykimet, përbuzjen, përçmimin ose fjalët e njerëzve të shoqërisë që i rrethon, ose edhe të njerëzve më të afërt, që mund të arrijnë deri në braktisjen e plotë të këtyre personave. Më kujtohet kur isha në Pekanbaru, një vend

pothuaj 100% islamik në ishullin e Indonezisë, dhe duke lëvizur nëpër spitalin publik të qytetit me mjekun pneumolog, po vizitonim pacientat e atij spitali, për të arritur pastaj tek pacienti “më i vështirë” dhe më i izoluar, i cili ishte me të vërtetë i izoluar për shkak të sëmundjeve të shumta që kishte. Ai ishte i sëmurë me AIDS, por në fakt shumë sëmundje të tjera e kishin goditur trupin e tij të shkretë, duke arritur të merrte edhe mbi 30 ilaçe në ditë, ndër të cilat edhe shumë gjilpëra! Por ajo që më bëri më shumë përshtypje kur arritëm pranë dhomës së tij, nuk ishte shumë izolimi fizik që ishte i detyrueshëm në atë rast, sa ai shpirtëror: përveç këtij mjeku dhe infermierëve që kujdeseshin për të, asnjëri nuk shkonte ta takonte (as nga larg) dhe as nuk donte t’ja dinte për të! Familja e tij e kishte braktisur tërësisht këtë djalosh të ri sepse ai ishte homoseksual dhe që kur e kishin marrë vesh për këtë, e kishin braktisur, duke mos i rënë më ndërmend për të, as në këtë gjendje në të cilën ndodhej fëmija i tyre, dhe më besoni, ishte një gjendje që mund të prekte edhe njeriun më të keq në botë!

Pra, e dhashë këtë shembull, por secili nga ne mund të mendojë për rastet personale që mund t’i kenë qëlluar të kalojë ose të dëgjojë, dhe kështu secili nga ne mund të kuptojë se si bota e një të sëmurit është një botë më vete, ku lindin shumë probleme dhe shqetësime, mendime, pikëpyetje që kanë të bëjnë jo vetëm me gjendjen fizike të dobësuar, që është mjaft e rëndë edhe kjo, por edhe me anën psikologjike, shpirtërore e morale. **Gjatë sëmundjes, shumë mendime, shumë pyetje, shumë ndjenja, përjetime, kujtime, mund të përshkojnë mendjen e zemrën e të sëmurit: mund të vijjnë ndenjat e shkurajimit, e frikës (frikë për shëndetin, frikë për të ardhmen, frikë për të afërmit e për fëmijët, sidomos nqs janë të vegjël), e pasigurisë (për jetën, për ekonominë, për të ardhmen), të negativitetit (nuk kam çka i duhem kujt kështu, vetëm i bëhem barrë, s’duhem për asgjë, s’kalohet jeta kështu i sëmurë, duke ndenjtur shtrirë në krevat), e impotencës (nuk mund të bëj asgjë në këtë gjendje, as për veten time, as për të tjerët, as për shoqërinë, s’i duhem askujt, s’jam për asgjë tashmë).** Plogështia, trishtimi, shkurajimi, mosbesimi, dhe në fund dëshpërimi mund ta bëjnë lehtësisht pre një të sëmurë, duke e çuar edhe në mendime apo gjeste më ekstreme, si psh vetëvrasja, ose vetëvrasja më “elegante” e ditëve tona, eutanasia, e ashtuquajtura vdekja e ëmbël. Nuk është ky as momenti, as vendi i duhur për të folur gjatë për këtë temë, po a e kemi menduar ndonjëherë se në bazën, në themelin e këtyre gjërave qëndrojnë pikërisht disa flatra të prera, të bëra copë copë, që janë flatrat e jetës, dëshira e madhe për të jetuar e për të qenë mirë, për të patur shëndetin e për të bërë shumë gjëra të bukura që do të dëshironim t’i bënim, për të bërë edhe ato gjërat normale, që i bëjnë të gjithë. Pse një njeri shkon deri në absurditetet e ditëve të sotme, në vdekjen e “ëmbël”, pra të zgjedhë me sy hapur vdekjen e vet, të mos jetojë më, se sa të jetojë në një gjendje sëmundjeje kronike? Po dëgjoja këtë rastin e fundit të njeriut nga Kolombia, një pacient jo terminal, i pari në Kolombi që kishte bërë eutanasinë, dhe ishte përbiles krenar, sipas atyre të cilëve ua kishte thënë përpara se t’ja bënin, e donte të jepte një shembull!

Kuptohet që vuajtja fizike dhe shpirtërore e një njeriu që është i sëmurë, sidomos pra me sëmundje të rënda, të vazhdueshme, kronike, që nuk dihet a kanë shërim ose sigurisht nuk e kanë, është shumë e madhe, e paimagjinueshme për atë që nuk e kalon vetë në trupin e vet, në jetën e vet. Atëhere pra, lind nevoja që këta njerëz, këta vëllezër e motra, të marrin një ndihmë më tepër, përveç atyre ndihmave që janë “të zakonshme” dhe për të gjithë. Mjeku i madh Jezu Krishti, Mjeku i Mjekëve, Shefi Suprem i çdo lloj reparti të çdo lloj spitali në botë, duke qenë tejet i mëshirshëm, i kuptueshëm, empatik me të gjithë, por më në veçanti me të sëmurët, ka dashur jo vetëm t’i ndihmojë dhe pse jo, edhe t’i shërojë, por është identifikuar ai vetë me ato, duke dashur të marrë gjatë Mundimit të tij mbi shpinë çdo lloj vuajtjeje, si fizike ashtu shpirtërore, duke u bërë ai vetë Njeriu i Dhimbjeve, sikurse thotë profeti Isaia:

*Ishte i përbuzur, më i sprasmi ndër njerëz,
 njeri dhimbjesh, i regjur me vuajtje,
 si ai, para të cilit mbulohet fytyra,
 i përbuzur, këndeje as s'e çmonin për gjësend!
 E pra, Ai i mori mbi vete vuajtjet tona,
 mbi shpatulla të veta i ngarkoi dhimbjet tona!
 E ne ishim të bindur se ishte i ndëshkuar,
 i munduar prej Hyjit e i nënçmuar!
 Kurse Ai ishte i plagosur për shkak të paudhësive tona,
 i ndrydhur për shkak të fajeve tona;
 ndëshkimi, peng paqeje për ne,
 peshoi mbi Të:
 me plagët e tij ne u shëruam.*

(Isaia 53, 3-5)

Konkretisht, efektet e Sakramentit të Vajimit janë këto:

- a. Një dhuratë e veçantë e Shpirtit të Shenjtë. **Hiri themelor i Vajimit është ngushëllimi, paqja dhe kurajoja për të përballuar vështirësitë e vetë gjendjes së sëmundjes së rëndë ose të dobësisë së pleqërisë.** Disa nga këto dobësi e vështirësi i përmendëm edhe më sipër. Pra, ky Sakrament ripërtërin dhe përforcon besimin në Zotin, na mbron dhe na forcon kundër tundimeve të të keqit, sidomos kundër tundimit të shkurajimit dhe të ankthit që përjetohet gjatë sëmundjes e sidomos në prag të vdekjes. **Kjo mbështetje e çon të sëmurin sigurisht drejt shërimit të shpirtit, që është gjëja themelore për një njeri në këtë botë, dhe nqs është vullneti i Zotit, edhe në shërimin e trupit.** Imagjinoni çfarë force dhe çfarë hiri të jashtëzakonshëm mbart në vetvete. Mund ta imagjinojmë këtë sakrament, për të bërë disa analogji, sikur doza e vaksinës Booster për të cilën po flitet më shumë tani, ose sikur një Turbo: kur luanim në kohët tona lojëra playstation, thuhej shpesh “futi turbo, futi turbo”, për të shpejtuar, për të përforcuar kur po humbisje.... ja një gjë të ngjashme bën edhe Vajimi me të sëmurin, i cili është sikur ata makinat që po humbasin energji.
- b. Po ashtu, nëpërmjet këtij Sakramenti të sëmurit i falen mëkatet. Cilat mëkate falen nëpërmjet Vajimit? **Vajimi fal mëkatet jo të rënda**, pasi në mënyrë të zakonshme, ashtu sikurse kemi thënë kur kemi folur për Rrëfimin (shiko: Sakramenti i Rrëfimit), mëkatet e rënda falen nëpërmjet Rrëfimit. Gjithsesi, në situatat ekstreme, kur nuk është e mundur që të bëhet Rrëfimi, Vajimi mund të falë edhe mëkatet e rënda, me kushtin themelor që normalisht i sëmuri që merr këtë Sakrament të Vajimit të jetë i penduar, të paktën me pendim jo perfekt (për dallimin midis pendimit jo perfekt dhe atij perfekt shiko: Sakramenti i Rrëfimit). Edhe për këtë arsye, pikërisht sepse ka këtë fuqi të falë mëkatet, Vajimi mund të administrohet vetëm nga priftërinjtë, sikurse folëm më sipër.
- c. **Për hirin e Vajimit, i sëmuri merr forcën dhe dhuratën që të bashkohet në mënyrë më intime me Mundimin e Krishtit.** I sëmuri, në një farë mënyre, kushtohet që të sjellë më shumë fryte nëpërmjet konfigurimit, përngjashmërisë së tij me Mundimin shëlbues të Shpëtimtarit. Pra, çdo i sëmurë bëhet kështu bashkëpunëtor me Jezu Krishtin në shëlbimin e botës. Ou, fjalë të mëdha! Konkretisht, çfarë po thua? Konkretisht është e vështirë për ta kuptuar! Nqs njeriu nuk i jeton këto realitete, mbeten thjesht fjalë të bukura, bla bla bla...

Por në fakt ky është një nga elementet thelbësore jo vetëm të jetës sonë, por edhe të fesë sonë.



Mbaj mend një takim me një shok indian, i lindur dhe i rritur në një familje hindu, praktikante. Nëna e tij i kishte mësuar shumë gjëra të mira në lidhje me fenë (apo filozofinë?) e tyre, por atë përveç të tjerave, një gjë nuk e kishte bindur aspak. Pikërisht kur po bashkëbisedonim e shkëmbejin biseda të tilla që në fillim ishin vetëm të tipit ekzistencialiste, filozofike, me një panoramë që të lë pa fjalë të Qytetit të amshuar, që shtrihej para nesh shumë e bukur, shumë antike dhe po aq romantike nga ballkoni panoramik i Gianicolos në Romë, ky shok indian më thotë: Vetëm një gjë më ka bërë që të largohem sepse feja ime nuk i jep dot asnjë shpjegim, nuk i jep një kuptim: vuajtjes! Nuk e di se çfarë thashë apo bëra pas kësaj, ndoshta thjesht vazhdova të shijoj pamjen e bukur në sipërfaqësinë time, sepse në fakt ky reflektim i këtij djali indian, ekspert i fizikës kuantike, prandaj mund ta imagjinoni pak a shumë si ata protagonistët e Big Bang Theory, ma hodhi ashtu si bombë. Dhe edhe unë vetë, edhe pse e quaja veten të krishterë që atëhere, nuk ja kisha pyetur ndonjëhere vetes: cili është kuptimi që i jep feja ime vuajtjes? Ose më përpara se kaq: a i jep ndonjë kuptim feja ime vuajtjes, që në vetvete është e pakuptimtë dhe e kotë, për ta larguar në të gjitha mënyrat dhe për ta hequr qafe sa më shpejt?

Po, feja jonë, Kisha jonë, Zoti ynë, Jezu Krishti, i jep një kuptim dhe një vlerë të re, të madhe, të jashtëzakonshme vuajtjes. ***Me Jezusin dhe në Jezusin, njeriu që vuan, pra edhe dhe mbi të gjitha i sëmurë si fizik, si shpirtëror, mund t'i bashkohet Vuajtjeve të Jezusit, mund t'i pranojë këto vuajtje dhe t'i ofrojë për shpëtimin e shpirtit të vet dhe të vëllezërve e motrave të tij, duke filluar nga familja e tij.*** Kjo gjë është aq e vërtetë dhe aq themelore, sa nqs kuptohet dhe jetohet me të vërtetë nga i sëmurë, jeta e tij besoj se do të ndryshonte tërësisht. Kam njohur personalisht disa persona, të cilët përpara kishin qenë shumë larg Zotit, me një jetë përbiles mjaft të shthurur, të cilët i kam takuar në kishë dhe më thonin: Babai im ka qenë shumë i sëmurë me tumor dhe në fund të jetës së tij na ka thënë që kishte ofruar sëmundjen, vuajtjen e jetën e tij për kthimin tim, që unë të ndryshoja jetë. Dhë në fakt kështu kishte ndodhur, sepse unë kisha filluar të ndryshoj jetesën, pikëpamjen e t'i afrohem Zotit që përpara se ai të vdiqte.

Ose rasti i një vajze, Marthe Robin, e cila në moshën 16 vjeçare, nga një adoleshente e thjeshtë dhe e qeshur e Francës juglindore që ishte, kthehet në një invalide përgjithmonë: ajo goditet në mënyrë të papritur nga një sëmundje, e quajtur "Encefalit Letargjik", e cila e lë të paralizuar dhe me probleme shikimi, derisa më 3 tetor të vitit 1926 nuk arrin të hajë më asgjë dhe kështu i jepet Vajimi Ekstrem, pasi mendohej se ajo ishte në prag të vdekjes. Por,

që nga ai moment, pikërisht atëhere kur shpresat dukej se kishin mbaruar, Marthe-s i shfaqet Shenjtja Terezina e Lisieux, e cila i thotë se jeta e saj nuk do të përfundonte atë natë dhe se tashmë ajo kishte një mision specifik në këtë tokë, edhe pse e sëmurë, ose më mirë, pikërisht nëpërmjet vuajtjeve të kësaj sëmundjeje. Kështu Marthe e pranon sëmundjen e saj, i pranon të gjitha vuajtjet dhe që nga ai moment ofrohet si një peng dashurie për Jezusin e për shpëtimin e njerëzve. Një nga gjërat më karakteristike për të cilat është e njohur kjo vajzë është se ajo, duke qenë e paralizuar në të gjithë trupin, për 50 vite as nuk ka ngrënë, as nuk ka pirë asgjë, por është ushqyer vetëm me... çfarë? Eukaristinë! Pra, për 50 vite është ushqyer vetëm me Eukaristinë! Po ashtu, as Eukaristinë nuk e përtypte (se ishte e paralizuar) por sapo ja vinin ndër buzë, zhdukej papritmas, dhe shumë njerëz kanë dëshmuar që e kanë parë me sytë e tyre këtë fenomen. Ajo kishte dhurata të shumta nga Zoti dhe u bë këshilluesja e qindra e qindra njerëzve, ndër të cilët edhe përfaqësues të lartë të klerit dhe vetë president francez i asaj kohe, Charles de Gaulle. Pra, nga një fshatare e thjeshtë, në një shenjte, në një njeri të kërkuar e të dashur nga e gjithë Franca, edhe pse për botën krejt e panevojshme, e paralizuar, e kotë. Ja një pjesë nga libri që ka shkruar për të poeti francez Jean-Jacques Antier “Le voyage immobile (udhëtimi palëvizur)”:



“Ajo i ngjante një fëmije, edhe në zë përbiles. Ishte e gëzuar, zëri i saj i dobët dhe i ulët, kënga e saj si kënga e një zogut. Gjestet e saj shprehnin esencën e papërcaktueshme të poezisë. Nuk kishte asnjë talent, përveçse në fëmijërinë e saj, qëndisjen. Përtej çdo lloj kulture, përtej çdo varfërie, ajo ushqej me ajrin, me kohën dhe me përjetësinë. Përbiles përtej edhe vetë vuajtjes. E megjithatë, menjëherë e pranishme për gjithçka e për të gjithë”.

6. NQS KY SAKRAMENT ËSHTË KAQ I RËNDËSISHËM, PSE POTHUAJ ASNJERIU NUK I BIE NDËRMEND PËR TË?

Kjo pyetje nuk është një kurth, është e vërtetë sepse shpeshherë ndodh kështu. Mund të jenë të shumta arsyet se pse ky Sakrament nuk praktikohet, se pse pra konkretisht, nqs psh. kemi një gjysh të sëmurë që është përkeqësuar mjaft nga ana e shëndetit, nuk na bie ndërmend që të shkojmë të flasim me priftin dhe të lëmë dakord me të një datë e një orar që të vijë e t'i administrojë këtë Sakrament gjyshit.

- a. **Arsyeja kryesore është sepse nuk e njohim këtë Sakrament.** Disa nga ne nuk e njohin fare Vajimin, ndoshta as nuk e dinin ose nuk e mbanin mend që është një ndër 7 sakramentet e Kishës Katolike. Por edhe sikur ta njihnim me emër, nuk ka çka na duhet një njohuri e tillë teorike. Këtë njohuri vetëm teorike mund ta marrim, si letrën higjienike dhe ta hedhim në WC, sepse s'ka çka na duhet! Me gjithë respektin, por teoria në fe, pa praktikë, pa mishërim, pa jetë, nuk duhet asgjë, janë vetëm fjalë boshe që i merr era. Pra, duhet ta njohim

thellësisht, dmth t'ja dimë rëndësinë dhe efikasitetin e tij, se sa shumë e ndihmon dhe e lehtëson të sëmurin, e për këtë arsye të vrapojmë që t'ja japim një ndihmë të tillë.

- b. **Një arsye tjetër është se ndoshta asnjë nuk na ka folur në lidhje me këtë Sakrament.** Fatkeqësisht, në përgjithësi anashkalohet së foluri, si nga ne besimtarët e thjeshtë, por ndoshta (guxoj të them) edhe nga vetë fetarët dhe priftërinjtë, më shumë në lidhje me këtë Sakrament dhe anashkalohet, lihet mënjanë së nxituri besimtarët që ta njohin dhe ta praktikojnë këtë sakrament, normalisht kur është e nevojshme. Pra, nga kjo vjen ftesa që të gjithë ne duhet të angazhohemi në çfarëdo lloj mënyre për ta bërë të njohur këtë Sakrament: duke folur për të kur është e nevojshme, duke i nxitur ata të sëmurë apo të afërmit e tyre që i njohim, që, pasi t'i kemi treguar mirësinë e këtij sakramenti, ta marrin atë për të sëmurit e tyre.
- c. **Një tjetër arsye mund të jetë sepse ne mund të kemi një farë turpi ose ngurrimi për të marrë këtë Sakrament, ose më mirë, për të thirrur priftin për të na e dhënë ose për t'ja dhënë të sëmurit që ka nevojë, këtë Sakrament.** Si çdo Sakrament tjetër, armiku nr.1 i zemrës sonë, pra djalli, e ka inat, e urren dhe nuk do në asnjë lloj mënyrë që t'i jepet ky Sakrament një të sëmuri, pikërisht për efektet e mrekullueshme që prodhon në të. Atëhere do të shpikë çdo lloj pengese, të brendshme (pra në mendjen tonë, në mendimet e fantazitë tona) ose të jashtme (rrugë që bllokohen, pamundësi të ndryshme) për të mos na lejuar që të merret Vajimi. Atëhere, është e rëndësishme të dimë që efekti që prodhon ky Sakrament është i aq i madh dhe aq i rëndësishëm, pasi ai fal edhe mëkatet kështu që ka aftësinë të lirojë të sëmurin nga mëkatet (gjithmonë nqs ky i fundit është i penduar) dhe t'i shpëtojë shpirtin, përveçse t'i japë ngushëllimin shpirtëror të madh gjatë mundimit të madh që ai provon për sëmurdjen dhe agoninë e tij, sa nuk ja vlen të vëmë në vend të parë asnjë mendim tjetër që e kundërshton marrjen e këtij Sakramenti: si psh, jo më vjen turp t'i them priftit të vijë tek shtëpia, jo s'kam shkuar kurrë tek kisha e do më thotë po ti kush je, kush të njeh; nuk e njoh aq mirë priftin, prifti është i zënë imagjino do vijë për mua, ka plot njerëz me kë të merret ai; ose më keq akoma se mos po ma gjen shtëpinë pis ose pak rrëmujë e më del nami (se ne shqiptarët e kemi shumë përzemër këtë aspekt që të mos na i shohin shtëpitë rrëmujë, as edhe një lodër e vogël nuk mund të mos jetë në vendin e vet se bëhet nami!). Këto ishin disa nga motivimet krejtësisht sipërfaqësore në krahasim me madhësinë e këtij sakramenti e përsëris, që më erdhën në mendje dhe që desha t'i ndaj me ju. Mos e lini pas dore këtë sakrament për asnjë arsye, sado e vlefshme dhe e arsyeshme t'ju duket!
- d. **Një arsye e fundit që më vjen në mendje që mund të na bëjë të ngurrojmë së marri sakramentin e vajimit për një të sëmurë është një paragjykim i thellë që është krijuar ndër vite, pothuaj si punë supersticioni, për këtë sakrament.** Duke qenë se thamë ky Sakrament quhej ndryshe edhe Vajimi ekstrem, pasi gjatë shekujve priftërinjtë e kanë administruar atë të sëmurëve në prag të vdekjes, pra qëllonte pothuaj përherë që pak pasi merrnin këtë Sakrament të sëmuret vdisnin, atëhere ku sakrament lidhet gjithnjë me fjalën vdekje: dmth çfarë ka shpikur mendja e tërthortë e disa besimtarëve? Duke qenë se pasi marrin këtë Sakrament i sëmuri vdes, atëhere s'po e thërras priftin që t'ja japë, sepse s'dua të vdesë i afërmi im i sëmurë, sepse pasi t'ja japë pra, do të vdesë. Deduksion më pa llogjikë dhe pa kuptim nuk është parë ndonjëherë! Po llogjiko pak, vëre pak trurin në lëvizje: nqs ti e thërret priftin vetëm në momentin e fundit, kur i sëmuri për shkak të sëmurdjes së tij që e mundon tashmë prej kohësh është duke e lënë këtë jetë, duke dhënë frymën e fundit, dhe ai i jep vajimin, e pas pak kohësh, mund të jenë orë, mund të jetë maksimumi ndonjë ditë, i afërmi yt i sëmurë vdes, a thua vallë nuk është prej Vajimit por prej sëmurdjes? Mos more, Nard Ndoka! Dhe a thua vallë, po të mos e kishe thirrur priftin për t'ja bërë Vajimin, prapë se prapë do kishte vdekur? Mos more, Nard Ndoka! Ça po na thua, gjëra të reja, të papame!

Kështu pra, mund të duket budallallëk ai që po them, por kam dëgjuar disa priftërinj që kanë folur për këtë problem dhe për këtë si punë “supersticioni”.

Normalisht, tani po e ktheja pak në shaka për të z dramaturgizuar, por duhet të kemi shumë kujdes sepse pas këtyre dinamikave njerëzore nuk fshihet vetëm injoranca, por mbi të gjitha është frika e vdekjes e sidomos frika e humbjes së njeriut të dashur dhe mendja e zemra jonë, vetëm e vetëm për të mos e humbur është e gatshme të shpikë çdo lloj gjëje. E kuptueshme, por të mos i bëjmë keq të sëmurit duke lejuar paragjykime e frikëra të tilla që të na futen në palcë, sepse vdekja fatkeqësisht mund të jetë një rrjedhojë e trishtë e sëmundjes, por Vajimi përkundrazi, është jetë për të sëmurin në ato momente, sepse kemi folur për efektet e tij, i jep forcën dhe hirin për të përballuar ato çaste të tmerrshme me forcën e jashtëzakonshme të Zotit.

Po ashtu, nqs kjo gjë mund t’ju ngushëllojë, dua të ndaj me ju një “gafë” që kam bërë në fillimet e rrugëtimit tim të krishterë, pas kthimit tim, kur nuk ja kisha idenë se ç’a ishte Vajimi. Isha në Meshë dhe papritmas shikoj shumë njerëz që çohen nga stolat dhe drejtohen për tek prifti, i cili u bënte një shenjë në ballë dhe pastaj ata uleshin prapë. Pa kuptuar se për ç’a e tek po shkonin, ngrihem edhe vetë nga vendi, futem në radhë me të tjerët për të marrë edhe unë këtë ritual. Vetëm se fillova të dyshoj fort, e para ngaqë jo të gjithë ishin çuar për të shkuar tek prifti, e dyta sepse të gjithë, si para si pas meje, ishin të moshuar, mjaft të moshuar... shumë të moshuar! Mmm-po mendoja me veten- si ka mundësi? Vetëm unë e re midis këtyre të moshuarve?! Mos jam në radhën e gabuar?! Dhe kështu, si një *outsider* i vërtetë, arrita përpara priftit, më leu ballin me vaj, u ktheva në vend dhe kur dëgjova fjalën “Vajim”, thashë me vete “ç’a do të jetë, ç’a do të kem marrë?!”... kur fillova të informohem mbi këtë “vajimin” e kuptova se çfarë “marrëzie” kisha bërë!!! Marrëzi e bukur, nuk isha e sëmurë, nuk isha e plakur (jo dhe aq të paktën hahaha) dhe nuk isha as në prag të vdekjes (falë Zotit), por ja e kisha marrë Sakramentin e Vajimit, pa e ditur! Dhe imagjinoni, çudi e madhe, pasi e mora... nuk vdiqa! :D Kështu që ka shpresë për të gjithë, siç thuhet, përderisa ka për mua dhe “marrëzitet” që kam bërë për shkak të injorancës sime!

7. KËNGA E MJELLMËS

Kënga e mjellmës?! Ishe mirë, ç’pate? Do të thoshte një xhaxha imi, i cili e kishte zakon të thoshte këtë frazë, kur dikush dilte me ndonjë muhabet pa lidhje papritmas. Në fakt në gjuhën shqipe nuk ka asnjë lidhje, por në gjuhën italiane ka një kuptim shumë të bukur e të thellë e doja ta ndaja me ju, për të folur për argumentin e fundit në lidhje me Sakramentin e Vajimit, që është Vajimi Ekstrem. Thamë që për shumë kohë Kisha ja ka dhënë Sakramentin e Vajimit atyre të sëmurëve që ishin në prag të vdekjes, e prandaj Vajimi njihet ndryshe me emrin Vajimi ekstrem, që është pra dhënia e këtij sakramenti për herë të fundit një të sëmurit, para se ai të vdesë. Është një moment shumë i rëndësishëm, për të cilin është tepër e rëndësishme që të mendojmë, edhe pse në ato çaste mund të na duket se mendja mendon për gjithçka, përveçse për këtë. E kam fjalën duhet ta mendojmë dhe ta dëshirojmë e ta bëjmë për veten, ashtu sikurse edhe për të afërmit tanë. Kam dëgjuar shumë njerëz të thonë “Oh, lutja që i bëj Zotit ditë e natë është që të vdes pa dhimbje e pa ju bërë barrë askujt, aq më tepër pa ngelur në shtrat, se atëhere s’ka ç’a më duhet jeta; lutja që i bëj përditë është që të vdes pa ditur e pa dëgjuar asgjë, mundësisht në gjumë, tak fak!” E rrezik bëjmë edhe ndonjë quiz, nga ato që na propozonte Facebook-u, sidomos në fillimet e viteve 2000, kur na thoshte “Si do të vdesësh?” e ne ishim të kënaqur kur na dilte ndonjë vdekje pa dhimbje. Përtej shakave tani, jo, jo dhe jo! Vdekja ideale për një të krishterë nuk është vdekja pa dhimbje, as vdekja në gjumë, e as (edhe pse e uroj për të gjithë ne se është diçka tepër e mirë) pranë të dashurve tanë: **e vetmja gjë që duhet t’i lutemi Zotit e**

sidomos Shën Jozefit, i cili është mbrojtësi i atyre që vdesin dhe mbrojtësi i vdekjes së mirë, është që të vdesim sikur ka vdekur ai (prandaj është bërë edhe mbrojtësi i këtyre realiteteve), pra në krahët e Jezusit dhe të Marisë. Duke qenë se ne nuk e kemi fatin që të vdesim në krahët e Jezusit e të Marisë materialisht si ai, mund të vdesim shpirtërisht, në hirin e tyre: konkretisht pra duke marrë Sakramentet e tyre.

Praktikisht, Kisha Katolike përcakton si Sakramente që mbyllin jetën tokësore të çdo njeriu Sakramentin e Rrëfimit, të Vajimit Ekstrem dhe të Eukaristisë (Kungimit), e cila quhet në këtë Viatiku, pra Kungimi i fundit, Kungimi i kalimit nga kjo botë në gjirin e Atit të amshuar.



Këto sakramente janë ato çelësa, që nqs shkoni në Vatikan mund të shikoni statujën e Shën Pjetrit, që mban disa çelësa në dorë, përpara së cilës një dajë imi dridhej gjithnjë duke thënë “Ja ai që ka çelësat e Parajsës, që ja hap derën kujt të dojë e ja mbyll kujt të dojë”. Nuk është krejt ashtu, dhe është shumë më pak e frikshme se sa ajo që mendojmë, edhe më pak misterioze, nqs ne pranojmë që të marrim këto tre Sakramente në

fund të jetës sonë: janë këto Sakramente çelësat e Shën Pjetrit, janë ato që na shpartallojnë dyet e Parajsës dhe na ndihmojnë që të shkojmë në gjirin e Atit, aty ku na pret Ati, Jezusi, Shpirti i Shenjtë me të gjithë engjëjt e shenjtërit. Sado e tmerrshme dhe e dhimbshme që të jetë vdekja që kemi përballë, qoftë e jona kur t’i vijë koha, qoftë ajo e një të afërmi apo shoku tonë, ankthi e trishtimi të mos na paralizojnë, por shpresa, besimi e dashuria të na shtyjnë që t’i drejtohem një prifti për t’i dhënë të dashurit tonë që po ikën nga kjo jetë sakramentet e jetës së amshuar.

Duhet të kemi parasysh që edhe nqs i sëmuri ka humbur tashmë vetëdijen, mund t’i jepet Vajimi, kështu që edhe në këtë rast mund të thirret prifti, nqs përpara i sëmuri ka shprehur lirisht vullnetin për ta marrë. Gjithçka pastaj varet nga gjendja shpirtërore e të sëmurit dhe nga pendimi i tij.

Po mirë, po ajo puna e mjellmës? Se aty më ngeli mendja mua... Në italisht përdoret një shprehje “kënga e mjellmës” për të treguar në përgjithësi shenjën e fundit të jetës së një njeriu. Përdoret kjo shprehje, sepse mendohej se mjellmat, kur u afrohej vdekja, në vend se të shuheshin në mënyrë të trishtë, shprehnin gëzimin e tyre me këngë akoma edhe më të bukura e më melodioze se sa ato që kishin bërë gjatë gjithë jetës së tyre. E mbyllim këtë Sakrament të Vajimit, të shkurtër por shumë të bukur e të rëndësishëm, duke ju lënë me fjalët domethënëse të Platonit, ndërkohë imagjinoni në sfond këngët e frymëzuara nga kjo legjendë të muzikantit vienez Schubert “Schwanengesang”, me shpresën që edhe secili nga ne të kalojë nga kjo jetë në jetën e amshuar i shoqëruar nga kënga e mrekullueshme dhe harmonike e tre mjellmave të arta: Sakramentet e Nënës sonë Kishë.



“Njerëzit gënjejnë edhe mbi mjellmat dhe mendojnë se ato, përpara se të vdesin, këndojnë prej dhimbjes. Por asnjë zog tjetër kur ka uri, ftohtë ose ndonjë shqetësim tjetër nuk e shpreh me këngë vuajtjen e vet. Mjellmat, të shenjta për Apollon, në fund të jetës së tyre, duke e parashikuar të mirën që do të gjejnë tek të bashkuarit sërisht me zotin e tyre, gëzohen. Në të njëjtën mënyrë, Sokrati, mik i mjellmave dhe jo më pak se ata profet, gëzohet. Ai është i sigurtë se, në momentin që shpirti i tij do të lirohet nga zinxhirët e trupit, do të rishikojë më në fund dritën e vërtetë”.